



këtë më datë 12.01.2018, me shkresën nr.K2/D20-3, i jemi drejtuar me kërkesë për informacion z. E. M., me detyrë drejtor i SH.Ç.B.A., pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Shtetit, por ende nuk është kthyer përgjigja.

Në ankesën e saj dhe më pas në deklaratimet e datës 10 Janar 2018, shtetasja D. M., ndërmjet të tjerave ka shpjeguar se, punonjësi i policisë G. B., i ka dërguar mesazhe duke iu shprehur *“se të kam xhan, kam nevojë për sytë zërin, flokët tuaja. E ndodhur në këto rrethana dhe duke parë insistimin e punonjësit të policisë me mesazhet ngacmuese, shtetasja D. M., i është shprehur se “Ndërsa unë kam nevojë që ju t’me lini të qetë!.Nuk dua asnjë ndihmë prej jush, unë ju thashë që jam e fejuar .Ju erdhët këtu si inspektor, apo erdhët për qëllime të tjera, apo meqënëse unë kam nevojë për ndihmë ju doni të përfitonit?”*

Veç sa sipër ankuesja D. M., ka shpjeguar se punonjësi i policisë G. B., i ka premtuar për ta rregulluar në punë rrobaqepëse si, dhe për kopështin për fëmijën e saj, duke e çuar tek kopështi privat që ai ka, por pa i thënë se atje administratore ishte bashkëshortja e tij.

Ankuesja D. M., ka sqaruar gjithashtu se në një rast, në ditët e muajit Tetor 2017, punonjësi i policisë G. B., e ka ftuar për të parë kopshtin, dhe për këtë e ka çuar me mjetin e tij, tek një ndërtesë sipas saj “motel”, në të dalë të qytetit të Fierit, por D., e ka refuzuar duke i thënë që duhet ta çonte në shtëpi.

Për këto veprime më datë 19.12.2017, është ankuar në Zyrën Rajonale Fier të Institucionit të Avokatit të Popullit. Për këtë shqetësim punonjësja e Zyrës së Avokatit të Popullit ka njoftuar drejtorin e SH.Ç.B.A të Drejtorisë Vendore Fier, z. M. A., i cili e ka dëgjuar ankuesen tek një lokal në qytetin e Fierit (në mungesë të zyrës) në prani të znj.L. R., duke e sqaruar se duhet të bënte kallëzim penal. Shtetasja D. M., ka qënë e tërhequr dhe e frikësuar për të bërë kallëzim penal, megjithatë i ka thënë z. A., se do ta njoftonte vetë atë, me anë të telefonit në rast se do të vendoste për bërjen e kallëzimit penal.

Gjatë kryerjes së hetimit të pavarur administrativ janë marrë shpjegime dhe punonjësit të policisë G. B., i cili ka shpjeguar se është interesuar për kopshtin e fëmijës së ankueses D. M., dhe në një rast tjetër e ka ndihmuar me një punonjës të O.E.SH.E-së pasi kishte probleme me kontaktorin e energjisë elektrike në banesën e saj, por nuk ka patur raste të dërgimit të mesazheve për ngacmime morale.

Duke analizuar në tërësi provat e administruara, konstatohet se, veprimet e vazhdueshme nëpërmjet dërgimit të mesazheve me përmbajtjet e cituara më lart, çuarja tek një ndërtesë në periferi të qytetit, ofrimi i ndihmës për t’i sistemuar fëmijën në kopësht etj, të punonjësit të policisë G. B., përbëjnë ngacmime morale që lidhen me ushtrimin e detyrës, të cilat kanë sjellë shqetësime dhe cënim të moralit e dinjitetit personal të shtetasës Denisa Merko. Në veprimet e tij gjatë përmbushjes së detyrës të punonjësit të policisë G. B., ka mosrespektim të etikës policore dhe standarteve profesionale, rrjedhojë e një performace të dobët profesionale dhe e papërshtatshme, me pasoja në humbjen e besimit të qytetarëve për realizimin e misionit të Policisë së Shtetit.

Ato vijnë ndesh me nenin 94 të ligjit nr.108/2014, Sjellja dhe etika, ku thuhet: *“Punonjësi i policisë është i detyruar të repsketojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave”*, si dhe nenin 112 të Rregullores së Brëndshme të Policisë së Shtetit të vitit 2015, ku thuhet: *“Punonjësi i policisë vepron në çdo kohë me ndershmëri dhe integritet të plotë”*.

Në nenin 2 të Kodit të Mirësjelljes për Zyrtarët e zbatimit të Ligjit (i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme , me rezolutën 34/169, të datës 17 Dhjetor 1979) thuhet : “Në kryerjen e detyrës zyrtarët e zbatimit të ligjit do të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe të mbajnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut të të gjithë personave”.

Sa sipër duke gjetur se ankesa e shtetas D. M., është e drejtë dhe veprimet e specialistit të policimit në komunitet Gramoz Beci, përbëjnë shkelje të disiplinës, në bazë të nenit 21gërma “c” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku thueht: “Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”,

### **REKOMANDOHET**

*“Fillimi i ecurisë disiplinore dhe marrja e masës disiplinore ndaj z. G. B., me detyrë specialist i policimit në komunitet të rajonit nr.3, pranë Komisarariatit të Policisë Fier”.*

Mbi masat e marra në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brënda afatit 30 ditor, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bshkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të proces verbalit të marrjes së shpjegimeve të ankueses D. M., datë 10.01.2018, proces verbal i marrjes së shpjegimeve të specialistit të policimit në komunitet G. B., datë 10.01.2018, shkresa nr.K2/D20-3 datë 12.01.2018, drejtuar z. E. M., dhe 11-njëmbëdhjetë-fletë me përmbajtje të mesazheve mes D. M., dhe G. B.

Dokumenta gjithësej 4-katër- me 29 –njëzet e nëntë- fletë.

*Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.*

Konc.&Dakt.P.A.  
Tiranë më 01.02.2018

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**